



KB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 2910 Prot.

Vlorë, më 20. 02. 2025

PROJEKTVENDIM

Nr. ____ datë ____ 2025

**“PËR DHËNIE TITULLI NDERI “QYTETAR NDERI I VLORËS “PROF. DR.
KRISTAQ KUME”**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 8 pika 2, pika 9.1, pika 1.1./b dhe pika 7/a, neni 54 pika m; në ligjin nr. 112/2013 datë 04.04.2013 “Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 14, neni 15, pika 1/a dhe 2/b, neni 16, Ligji Nr 94/2022 datë 22.12.2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendorë të Nderit”, me propozim të të Shoqatës Artistiko-Kulturore “Labëria” të depozituar pranë Protokollit të Bashkisë Vlorë me shkresën nr. 20721 Prot, datë 26.12.2024, të miratuar me Vendimin e Komisionit Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit të Këshillit të Bashkisë Nr. 3 datë 19.02.2025, si dhe në relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë së bashku me dokumentacionin shoqëruar, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës 25.02.2025

VENDOSI:

1. T’i japë titullin “Qytetar Nderi i Vlorës” Prof. Dr. Kristaq Kume, me këtë motivacion:
“Për kontribut të shquar në zhvillimin e arsimit dhe ekonomisë kombëtare përmes veprimtarisë së tij si matematicien dhe studiues, modernizimin e institucioneve të ndryshme shtetërore si dhe rolin kyç në forcimin e demokracisë vendore dhe proceseve zgjedhore në Shqipëri.”.
2. Për zbatimin e këtij Projektvendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë Vlorë, Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.



3. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6.

KRYETAR
Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 2910 Prot.

Vlorë, më 20.02.2025

RELACION

**MBI PROJEKTVENDIMIN
“PËR DHËNIE TITULLI NDERI “QYTETAR NDERI I VLORËS “PROF. DR.
KRISTAQ KUME”**

Para Këshillit të Bashkisë Vlorë

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak të Vlorës,

Po ju paraqesim për miratim Projektvendimin “Për Dhenien e Titullit “Qytetar Nderi” Prof. Dr. Kristaq Kume” i cili është një propozim i Shoqatës Artistiko-Kulturore “Labëria”.

Ky propozim mbështetet në vlerësimin e përgjithshëm për kontributin e tij të spikatur në zhvillimin e arsimit, kërkimit shkencor, ekonomisë dhe forcimin e institucioneve demokratike në Shqipëri. Prof. Kume është një figurë e njohur për integritetin e tij të lartë akademik dhe profesional, si dhe për përkushtimin e tij të vazhdueshëm në përparimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës.

Prof. Dr. Kristaq Kume është një nga intelektualët më të shquar të vendit tonë, me një kontribut të jashtëzakonshëm në fushën akademike, kërkimin shkencor dhe konsolidimin e institucioneve demokratike.

I lindur në qytetin e Vlorës, në lagjen Muradie, ai rrjedh nga një familje e njohur për vlerat e larta qytetare dhe kontributin në komunitet. Vet Prof. Dr. Kristaq Kume nuk i ka shkëputur asnjëherë lidhjet dhe kontributin me qytetin e tij të lindjes.

Kontributi në zhvillimin akademik dhe shkencor

Karriera e tij profesionale është e shquar për rezultatet dhe ndikimin që ka pasur në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Me përvojën dhe ekspertizën e tij, ai ka dhënë një

kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë, bujqësisë dhe blegtorisë, si dhe në përmirësimin dhe modernizimin e sistemit të arsimit të lartë në Shqipëri.

Puna e tij kërkimore dhe akademike ka ndikuar ndjeshëm në formimin e brezave të rinj të shkencëtarëve dhe studiuesve, duke i pajisur ata me njohuri të thelluara dhe aftësi analitike të avancuara.

Kontributi në forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës

Një ndër momentet më të rëndësishme të karrierës së tij ishte drejtimi i **Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (K.Q.Z)** gjatë zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 1997 dhe Referendumit për sistemin e qeverisjes në Shqipëri. Në një situatë tejet të ndërlikuar politike dhe sociale, ai ushtroi detyrën me një nivel të lartë profesionalizmi dhe integriteti, duke kontribuar në kapërcimin e krizës së asaj kohe dhe në forcimin e proceseve demokratike në vend.

Nga ajo periudhë e deri më sot, Prof. Kume ka qenë dhe mbetet një zë i rëndësishëm në avancimin e proceseve demokratike në Shqipëri. Ai ka dhënë ndihmesë të vyer në garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, si dhe në fuqizimin e institucioneve zgjedhore dhe shoqërisë civile përmes angazhimit të tij të vazhdueshëm në monitorimin, analizën dhe zhvillimin e kuadrit legjislativ dhe rregullator. Veçanërisht kontributi i tij është i dukshëm në ngritjen e demokracisë vendore.

Përkushtimi ndaj Vlorës dhe vlerave qytetare

Prof. Kume ka ruajtur gjithmonë lidhjen shpirtërore dhe intelektuale me qytetin e tij të lindjes, Vlorën. Ai ka kontribuar në zhvillimin akademik dhe institucional të Universitetit “Ismail Qemali”, duke ndarë dijet dhe përvojën e tij me studentët dhe stafin akademik. Gjithashtu, ka bashkëpunuar me Këshillin Bashkiak dhe qytetarët e Vlorës në adresimin e çështjeve të rëndësishme të qeverisjes vendore dhe demokracisë përfaqësuese.

Dekoratat dhe vlerësimet

Për kontributin e tij të shquar si intelektual me integritet të lartë, studiues dhe profesor, Prof. Dr. Kristaq Kume është vlerësuar me disa nga çmimet dhe dekoratat më të larta shtetërore, përfshirë:

- Urdhri “**Naim Frashëri**”
- Titulli “**Mjeshtër i Madh**”
- Dekorata “**Nderi i Kombit**”

Duke ju referuar kontributit dhe veprimtarisë sikurse cituam më lartë, propozimi i Shoqatës “Labëria” Dega Vlorë u shqyrtua edhe në Komisionin Këshillimor për Titujt e Nderit pranë Këshillit të Bashkisë i cili me Vendim nr.3 dt. 19.02.2025 vendosi që ti propozojë Këshillit Bashkiak që të dekorojë Prof. Dr. Kristaq Kume me titullin “Qytetar Nderi i Vlorës”.

Në vlerësim të gjithë këtyre kontributeve të jashtëzakonshme, Administrata e Bashkisë Vlorë vlerëson dhe propozon që Prof. Dr. Kristaq Kume të nderohet me titullin “Qytetar Nderi i Vlorës”, si shprehje e mirënjohjes për kontributin e tij të vyer në zhvillimin akademik, demokratik dhe institucional të vendit tonë.

Në bazë të argumenteve të sipërcituara dhe duke njohur kontributin e jashtëzakonshëm të Prof. Dr. Kristaq Kume në forcimin e shtetit të së drejtës, arsimit dhe kërkimit shkencor, si dhe për lidhjen e tij të pandërprerë me qytetin e Vlorës, i kërkojmë Këshillit Bashkiak të Vlorës të miratojë dhënien e titullit “Qytetar Nderi i Vlorës” për këtë personalitet të shquar.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

DREJTORI I PËRGJITSHËM RREGULLATOR

Dorian Demiri

